



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

Numri i Çështjes	300004-06897-80-2025	Data e Regjistrimit	12/08/2025
Numri i Vendimit		Data e Vendimit	14/08/2025

VENDIM NE EMER TE REPUBLIKËS

Gjykata Administrative e Shkalles se pare ***** E PERBERE nga:

KRYESUES: Marko Boshku

ANËTAR

SEKRETARE Sabina Hoxha

Objekti: Pezullimi i menjëhershëm i efekteve juridike të:
1. Urdhrit nr. 582, datë 05.08.2025, për transferimin nga pozicioni i Drejtorit Rajonal të AMP-së Vlorë-Gjirokastrë në detyrën "Keshilltar", në Kabinetin e Dretorit te Pergjithshem.
2. Urdhrit nr. 590, datë 06.08.2025, për përjashtimin nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore deri në përfundimin e gjykimit të padisë themelore për shfuqizimin e këtyre akteve si të pavlefshme dhe të paligjshme.

Baza Ligjore : Nenet 28—32 të Ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative", Nenet 200—202 të Kodit të Procedurave Administrative, Neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Kushtetuese dhe e Gjykatës Administrative

Përmbledhja e vendimit:

asistuar nga sekretaregjyqësore **Xhovidjana Suta**, në Tiranë, sot më datë 14.08.2025, në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve, mori në shqyrtim kërkesën për sigurimin e padisë, në lidhje me çështjengjyqësore Nr.Regj.Them. 168, Nr.ICMIS: 300004-06897-80-2025, regjistruar më datë 12.08.2025, me palë ndërgjyqëse, objekt dhe bazë ligjore, si më poshtë vijon:

KËRKUES:

*****, i biri i ***** dhe i Lule, i datëlindjes 15.04.1981, banues në Lagjia nr.14, Durrës, me email: *****@gmail.com, me nr.kontakti: 0692144446.

PERSON I TRETË:

Agjenciae Mbikëqyrjes Policore, me adresë: Rruga "Asim Vokshi", nr.19/1, Tiranë.

Me pjesëmarrjen e:

Avokaturës së Shtetit.

OBJEKTI:

Pezullimi i menjëhershëm i efekteve juridike të:
1. Urdhrit nr.582, datë 05.08.2025, për transferimin nga pozicioni i Drejtorit Rajonal të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

AMP-së Vlorë-Gjirokastrë në detyrën "Këshilltar" në Kabinetin e Drejtorit të Përgjithshëm; 2. Urdhrit nr.590, datë 06.08.2025, për përjashtimin nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore; deri në përfundimin e gjykimit të padisë themelore për shfuqizimin e këtyre akteve si të pavlefshme dhe të paligjshme.

BAZA LIGJORE: Nenet 28-32 të Ligjit nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative"; nenet 200-202 të Kodit të Procedurave Administrative; neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Kushtetuese dhe e gjykatës administrative.

GJYKATA:

- Në datën 14.08.2025, në zbatim të nenit 28/3 të Ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", mori në shqyrtim në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve ndërgjyqëse, kërkesën e kërkuarit ***** , i cili ka kërkuar: "*Pezullimi i menjëhershëm i efekteve juridike të: 1. Urdhrit nr.582, datë 05.08.2025, për transferimin nga pozicioni i Drejtorit Rajonal të AMP-së Vlorë-Gjirokastrë në detyrën "Këshilltar" në Kabinetin e Drejtorit të Përgjithshëm; 2. Urdhrit nr.590, datë 06.08.2025, për përjashtimin nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore; deri në përfundimin e gjykimit të padisë themelore për shfuqizimin e këtyre akteve si të pavlefshme dhe të paligjshme*".
- si shqyrtoi në tërësi aktetshkresore të depozituara së bashku me kërkesën administrative, në përputhje me dispozitat ligjore, si dhe referuar në ligjin organik me nr.49/2012 (lex fori) "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" indryshuar dhe me bindjen e brendshme,

VËREN:

I. Proceduragjyqësore.

Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me datë 12.08.2025 është dorëzuar nga pala kërkuar, ***** , kërkesa e posaçme për sigurimin e padisë, me palë ndërgjyqëse, objekt dhe bazë ligjore, sikurse cituar më sipër. Në bazë të Urdhrit Nr.78, datë 17.07.2025 dhe grafikut të gadishmërisë së gjyqtarëve për periudhën 29.07.2025-29.08.2025, jam caktuar unë gjyqtari Marko Boshku për gjykimin e kësaj çështjeje gjyqësore.

Referuar nenit 202 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 28 pika 3 të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

Ligjit nr. 49/2012 "Përgjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", kërkesa për sigurimin e padisë duhet që të merret në shqyrtim brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti kur dosja i paraqitet gjyqtarit. Kjo mënyrë erregullimit ligjor është e diktuar nga fakti që masa e sigurimit të padisë gjithmonë presupozon një nevojë urgjente dhe paraprake për shqyrtim në raport me shqyrtimin e çështjes në themel. Masat e sigurimit të padisë janë të lidhura integralisht dhe funksionalisht me padinë dhe se i shërbejnë gjithnjë ruajtjes së efektivitetit të padisë si mjet juridik. Nëse nuk respektohen garancitë procedurale për shqyrtimin e shpejtë të masave të sigurimit të padisë atëherë rrezikohet që vetë padia të shndërrohet në një mjet juridik joefektiv, teorik dhe iluzor dhe se kjo do të cenonte garancitë e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Po ashtu, referuar praktikës së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, gjykata nuk mund të refuzojë të shqyrtojë masën e sigurimit të padisë për arsyet që ajo lejohet nga ligji të mos shqyrtojë padinë në themel (**ndër të tjera shih: Vendimi Nr. 00-2020-90, datë 08.06.2020 i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**).

Në vijim të sa më sipër, Gjykata, në përputhje me nenin 28, 29 e 30 të ligjit organik me nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe nenin 202 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, vendosi që të marrë në shqyrtim në Dhomë Këshillimi, me detyrë të mbyllura dhe pa praninë e palëve ndërgjyqëse, kërkesën e palës kërkuese, ***** , për marrjen e masës së sigurimit të padisë administrative.

Gjykata Administrative çmon se, neni 28/3 i ligjit organik me nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" dhe neni 205/2 i Kodit të Procedurës Civile e lejon shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, në Dhomë Këshillimi dhe pa praninë e subjekteve të interesuara, në raste të ngutshme dhe të justifikuara (**injëti qëndrim është mbajtur dhe në vendimin 00-2021-762, datë 02.06.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**). Kërkesa duhet që të merret në shqyrtim brenda 5 (pesë) ditëve nga momenti kur dosja i paraqitet gjyqtarit. Poashtu, në **vendimin nr. 00-2021-181, datë 10.02.2021**, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka theksuar eksplicitisht që: "[...] 30. Në kushtet kur ligjvënësi ka parashikuar se kërkesa për vendosjen e masës së sigurimit të padisë mund të shqyrtohet në dhomë këshillimi (pa praninë e palëve) nga gjyqtari i vetëm për shkak të karakterit emergjent të saj, Kolegji vlerëson se, mosnjohimi i palës së paditur për shqyrtimin e kësaj kërkesë nuk e cenon procesin e rregullt ligjor, për sa kohë vendimi për caktimin e masës së sigurimit të padisë është i ankimueshëm sipas parashikimeve të nenit 209 të K.Pr. Civile dhe si i tillë, ai është i detyrueshëm për t'ju komunikuar palëve ndërgjyqëse, në mënyrë që ato të kenë mundësi mbrojtjeje, nëpërmjet ushtrimit të drejtës së ankimit të veçantë ndaj tij. [...]". Për më tepër, neni 25 i ligjit organik me nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

emosmarrëveshjeve administrative” lejon që të gjitha veprimet përgatitore, dukepërfshirë edhe marrjen e vendimit të sigurimit të padisë, mund të merren nëDhomë Këshillimi, vetëm në prani të gjyqtarit dhe sekretarisë gjyqësore.

Po ashtu, Gjykata çmon të nënvizojë faktin që, edhejurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut e ka legjitimuarshqyrtimin e kërkesave të tilla të ngutshme, sikurse është kërkesa e marrjes sëmasës së sigurimit të padisë administrative, pa praninë e palëve. Në çështjen “*Micallef k. Maltës*”, datë 15.10.2009,në Dhomë të Madhe, kjo Gjykatë ndër të tjera është shprehur se: “[...] Gjykata pranon që nëraste të jashtëzakonshme - në rastet, p.sh., kur efektiviteti i masës sëkërkuar është në varësi të një procesi vendim-marrës të shpejtë - mund të jetë pamundur të jetë menjëherë në përputhje me kërkesat e nenit 6 [...]”. Ky qëndrim nënkuptonse parimi i kontradiktoritetit në shqyrtimin apo zbatimin e këtyre masave bie për aq kohë sa ato nuk çenojnë thelbin e kësaj të drejte. Në vijim tëjurisprudencës të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Kolegji Civil iGjykatës së Lartë, me vendimin nr.22, datë 19.01.2011, ka pranuar qartësisht se mosparaqitja e palëve në shqyrtimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit nuk e bën procesin të cënueshëm nga pikëpamjae vlefshmërisë, duke përcaktuar shprehimisht se: “[...] Gjykimi i kërkesës për marrjen e masës për sigurimin e padisë mund të zhvillohet edhe papjesëmarrjen e debitorit, për efekt të shpejtësisë që paraqet ky gjykim dheefektshmërisë që duhet të ketë marrja e kësaj mase, parashikuar kjo dhe nënenin 205 të Kodit të Proçedurës Civile, kurse gjykimi i kërtimeve të themelitqë paraqet paditësi me anë të kërkesë padisë nuk mund të zhvillohet pa praninëe debitorit [...]”. Efektshmëria dhe shpejtësia e shqyrtimit të kësajkërkesë kanë rëndësi më të madhe, sesa njoftimi rigorozi i palëve respektive.Kjo për shkak se, ky vendim është i cënueshëm gjatë procesit dhe mund tëndryshohet lehtësisht kur ndryshojnë rrethanat fillestare në bazë të së cilaveu shqyrtua kjo kërkesë.

Në vijim të sa më sipër u arsyetua, Gjykatavlerëson se, në rastin objekt gjykimi, marrja në shqyrtim ekërkesës për sigurimin e padisë administrative në Dhomë Këshillimi, me dyer tëmbyllura dhe pa praninë e palëve ndërgjyqëse, është në përputhje melegjislacionin në fuqi dhe me jurisprudencën ndërkombëtare e kombëtare.

II. Juridiksionigjyqësor administrativ, kompetenca dhe formimi i gjykatës.

Meqenëse, kërkesaadministrative është depozituar për gjykim, nga pala kërkuese, pranë kësajgjykate, bazuar në nenin 28/4 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeveadministrative”, kjo gjykatë është kompetente për gjykimin e kërkesës sëpalës kërkuese, për sigurimin e padisë.

Trupi gjykues përgjykimin e kërkesës, u formua në zbatim të nenit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

12/1 dhe nenit 25/1 të Ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe është caktuar sipas Urdhërit Nr.78, datë 17.07.2025 dhe grafikut të gadishmërisë së gjyqtarëve për periudhën 29.07.2025-29.08.2025.

III. Rrethanat e faktit.

Referuar akteve që ndodhen në fashikullingjyqësor rezultojnë se, ndërsa kërkuesi ***** ushtronte detyrën si Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (në vijim AMP) Vlorë & Gjirokastrë, me aktin administrativ, Urdhërin Nr.582, datë 05.08.2025 "Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së" të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, është vendosur transferimi dhe emërimi i tij në detyrën Këshilltar në Kabinetin e Drejtorit të Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së.

Ndërkohë, më datë 06.08.2025, një ditë pas transferimit dhe emërimit të tij në detyrën Këshilltar në Kabinetin e Drejtorit të Përgjithshëm në Drejtorinë e Përgjithshme të AMP-së, me aktin administrativ, Urdhërin Nr.590, datë 06.08.2025 "Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së" të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, është vendosur përjashtimi i kërkuesit ***** nga AMP-ja, duke i ndërprerë të drejtat administrative dhe financiare po më datë 06.08.2025.

Në rrethanat elartëcituar, duke mos qenë dakord me vendimmarrjen e AMP-së, si dhe duke pretenduar se i shkaktohet një dëm i rëndë, i pakthyeshëm dhe i atëçastshëm, kërkuesi ***** i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me kërkesën objekt gjykimi, për marrjen e masës së sigurimit të padisë, nëpërmjet pezullimit të zbatimit të akteve administrative, Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 "Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së" dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 "Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së", të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

IV. Pretendimet e palëve.

Pretendimet e kërkuesit ***** [1].

Pala kërkuese pretendon se:

- Transferimi në një pozicion jo të klasifikuar dhe jo të barasvlefshëm nuk mund të kryhet pa pëlqimin e kërkuesit të shprehur me shkrim pasi nuk është një lëvizje paralele sipas përcaktimeve të vendosura si referencë në urdhërin e transferimit.
- Pozicioni i punës së këshilltarit nuk përmendet dhe nuk përbën strukturë drejtuese apo funksionale menaxheriale të AMP-së dhe nuk ka asnjë bazë ligjore për ta konsideruar si pozicion të barasvlefshëm me atë të drejtorit rajonal. Si i tillë, emërimi në këtë pozicion është haptazi i jashtëligjshëm dhe arbitrar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

- Sipas nenit 62 pika 1 të Ligjit nr.128/2021, punonjësi i AMP-së i emëruar në detyrë në përputhje me funksionin që mban, mund të transferohet dhe të emërohet në detyrë brenda strukturave qendrore dhe vendore të Agjencisë, me urdhër të Drejtorit të përgjithshëm në njëpozicion paralel/të barasvlefshëm. Në rastin konkret detyra e “Këshilltarit” nuk përfaqëson një pozicion të klasifikuar, të barasvlefshëm apo paralel me funksionin e mëparshëm të “Drejtorit Rajonal”, i cili është një pozicion ifituruar përmes konkurimit të ngritjes në detyrë me Vendimin nr.296/2, datë 23.01.2024 “Për shpalljen e rezultateve përfundimtar të testimit, për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë si dhe zhvillimin e konkurimit për vendet elira në AMP. Prandaj, ky transferim përbën shkelje të hapur dhe të drejtëpërdrejtë të nenit 62 të ligjit, duke cenuar rëndë sigurinë juridike dhe statusin e punës së kërkeusit.
- Transferimi përbën cenim të statusit të kërkeusit të fituar me konkurim për ngritje në detyrë. Transferimi përbën ulje në detyrë pa procedurë dhe jashtë çdo baze ligjore.
- Me urdhërin e paligjshëm të transferimit rrezikohet ndërprerja e procesit të vettingut, pasi kërkeusi është subjekt aktiv i vlerësimit kalimtar sipas ligjit përkatës nr.12/2018. Detyra e Këshilltarit nuk përfshihet në pozicionet e këtij procesi, ç’ka e rrezikondrejtëpërdrejtë vijimin dhe përfundimin e vlerësimit të kërkeusit.
- Meqenëse kërkeusi ushtronte funksionin e Drejtorit Rajonal, që sipas nenit 52 të ligjit nr.128/2021 është një funksion i klasifikuar në nivelin e mesëm drejtues, kërkeusi ka qenë subjekt i detyrueshmi këtij procesi. Transferimi i kërkeusit në një pozicion që nuk klasifikohet si drejtues dhe nuk është përfshirë në listën e pozicioneve që i nënshtrohen vlerësimit kalimtar, siç është “Këshilltar në kabinetin e Drejtorit të Përgjithshëm” përbën një ndërprerje të parakohshme dhe të pajustificuar të procesit të vettingut. Ky veprim administrativ e pengon kërkeusin të përfundojë procesin e vlerësimit dhe vendos në një pozitë të pabarabartë dhe me pasoja serioze në karrierën e tij brenda AMP-së.
- Sipas nenit 64 pika 3 të ligjit nr.128/2021 citohet se punonjësi i AMP-së përjashtohet kur: dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen me dashje të një vepre penale; ndaj tij është vendosur dhënia e masës disiplinore e përjashtimit nga Agjencia; nuk konfirmohet në detyrë në procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik.
- Urdhëri i përjashtimit është një veprim në mënyrë arbitrare dhe antiligjore vetëm një ditë pasi është firmosur urdhëri i transferimit në detyrën e këshilltarit, pa vendim të komisionit disiplinor, në shkelje flagrante të nenit 64 pika 3 të ligjit nr.128/2021.
- Transferimi dhe përjashtimi i kërkeusit nga AMP e ndërpret në mënyrë të paligjshme procesin, duke i mohuar përfitimin nga ky mekanizëm ligjor. Ligji i vettingut nuk parashikon që ky proces të vazhdojë për punonjës që transferohen në detyra që nuk janë subjekt i këtij ligji apo për punonjës që janë përjashtuar pa procedurë ligjore.
- Veprimet e AMP-së kanë cenuar statusin profesional të kërkeusit, dinjitetin dhe integritetin etik, me pasoja të rënda dhe të parikuperueshme nëse nuk pezullohen menjëherë.

V. Ligji izbatueshëm.

Neni 28 i Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin emosmarrëveshjeve administrative”, i titulluar “**Sigurimi i padisë**”, kusanksionohet: “1. *Meparaqitjen e padisë, paditësi mund t’i kërkojë gjykatës marrjen e masave të sigurimit të padisë, në rastet kur ai tregon se gjatë kohës*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

së nevojshme të procesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ. 2. Kërkesa për sigurimin e padisë, për shkak të rrethanave të çështjes, mund të paraqitet edhe para ngritjes së padisë. Në këto raste, gjykata, kur lejon sigurimin e padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se 10 ditë, brenda të cilit duhet të ngrihet padia. 3. Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në raste të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët. 4. Vendimi për sigurimin e padisë jepet në çdo fazë dhe shkallë të shqyrtimit gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë. Në të gjitha rastet gjykata duhet të arsyetojë vendimin e saj. Vendimi jepet nga gjykata, pranë së cilës ndodhet padia.”.

Neni 29 i Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin emosmarrëveshjeve administrative”, i titulluar “**Kushtet për sigurimin e padisë**”, ku sanksionohet: “Gjykata vendos sigurimin e padisë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme: a) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresë, për mundësinë e shkakut të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atë çastshëm për paditësin; b) nuk cenohet rëndë interesi publik; c) nëse shihet nevojshme nga gjykata, paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t’i shkaktohet të paditurit nga siguri i padisë.”.

Neni 30 i Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin emosmarrëveshjeve administrative”, i titulluar “**Llojet e masave për sigurimin e padisë**”, ku sanksionohet: “Sigurimi i padisë bëhet nëpërmjet: a) pezullimit të zbatimit të aktit administrativ, kontratës administrative ose veprimit tjetër administrativ; b) marrjes edhe të masave të tjera të përshtatshme, nga gjykata, në rastet kur vetëm pezullimi nuk ofron mbrojtje të mjaftueshme.”.

VI. Vlerësimi i Gjykatës.

Sa i përket rolit të gjyqtarit administrativ në raportet që krijohen midis organeve publike dhe subjekteve që afektohen nga veprimtaria administrative, vendet e europëskontinentale, janë ndarë midis konceptit subjektiv dhe objektiv të kontrollit gjyqësor të administratës. Sipas qasjes subjektive, gjykatat janë garant për respektimin e të drejtave subjektive të individit, të cilat cenohen nga administrata, në ushtrim të pushtetit publik. Ndërsa, qasja objektive vëtheqson tek kompetencat e gjykatës për të kontrolluar respektimin e ligjshmërisë nga administrata. Në interpretim të korpusit legjislativ mbi të drejtën administrative, referuar veçanërisht Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, në të drejtën administrative shqiptare, është mbajtur qëndrimi që gjykatat administrative nuk janë supermbikëqyrës të veprimtarisë së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

ekzekutivit, me qëllim konturimin e tijbrenda ligjit, por vlerësohen si mbrojtëse të të drejtave dhe lirive themeloretë individit ndaj çdo tejkalimi të pushtetit nga autoriteti administrativ.

Kontrolli gjyqësor ndaj veprimtarisë administrative, udhëhiqet nga parimi i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të individit nga ndërhyrjet e organeve administrative që në ushtrim të pushtetit publik, cenojnë këto të drejta. Ndërhyrja e pushtetit gjyqësor ndaj veprimtarisë së organeve publike është e tillë që, ndërsa garanton mbrojtjen e të drejtave të individit, nuk cenon kufijt e pushtetit diskrecional që ligji i ka konsideruar si domen ekskluziv i pushtetit administrativ. Në zbatim të nenit 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 4 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 3 të Ligjit nr.49/2012, Gjykata është e obliguar ligjërisht t'igantojë subjektit që ka kërkuar mbrojtje gjyqësore nga veprimet e sjelljet epaligjshme të një organi administrativ, mbrojtje e cila duhet të realizohet nëpërmjet një procesi gjyqësor në një mënyrë sa më efektive dhe brenda një afati të arsyeshëm. Për shkak të natyrës së veprimtarisë administrative, impaktit që krijon dhe pasojave që sjell në të drejtat e subjektit që ikundrejtohet, ndodh që, kontrolli nga pushteti gjyqësor i veprimtarisë administrative, në rrjedhën normale të procesit gjyqësor, humbet efektivitetin e tij. Për këtë arsye, ligjvënësi ka parashikuar mundësinë që subjektet e së drejtës që cenohen nga kjo veprimtari, të mund të mbrojnë të drejtat e tyre nëpërmjet institutit procedural të sigurimit të padisë.

Kërkesa për sigurimin e padisë, megjithëse është e lidhure kzistencialisht me padinë e themelit, është një kërkesë e llojit të veçantë që, ka si qëllim primar shmangien e dëmeve që mund të pësojë pala kërkuuese derinë marrjen e një vendimi përfundimtar nga gjykata. Gjykata çmon të rëndësishme të theksojë se, referuar të drejtës sonë procedurale, veçanërisht nenit 202 e vijues të K.Pr.Civile dhe nenit 28 e vijues të Ligjit nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", kërkesa për sigurimin e padisë nuksynon arritjen e një rezultati përfundimtar, apo të njëjtin rezultat si gjykimii themelit, por synon të garantojë që rezultati i këtij gjykimi të mos dëmtohet në rrjedhën normale të procesit gjyqësor, derisa gjykata të disponojë mbithemelin e mosmarrëveshjes. Në këtë kuptim, në Vendimin Nr.22, datë 19.01.2011, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera është shprehur se: *"Qëllimi i marrjes së masës për sigurimin e padisë referuar si legjislacionit shqiptar, por dhe legjislacionit ndërkombëtar është: (i) jo vetëm siguri i së drejtës, e cila përbën dhe tërësinë ekërkimeve që do të parashtrojë paditësi në padinë e tij, (ii) por në të njëjtën kohë dhe ajo që është më e rëndësishmja, është që të sigurojë efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor, i cili do të realizohet mes palëve në tëardhmen, në mënyrë që kjo e drejtë të cilën paditësi kërkon të realizojë dhe të njohë nëpërmjet një procesi gjyqësor, të mos jetë e kërcënuar nga një dëm imenjëhershëm dhe i pariparueshëm, dhe*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

që vendimi përfundimtar të mos mbetet ipaekzekutueshëm.”.

Sigurimi padisë si institut procedural civil, nënkupton një vlerësim paraprak dhe sipërfaqësor të fakteve të çështjes ngagjykata, e cila, nëse arrin në përfundimin se, ka arsye të dyshohet që derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekziston mundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm për palënpaditëse, vendos për marrjen e masave të përshtatshme, sipasnevojave të rastit konkret. Në këtë kontekst, pala kërkuese/paditëse duhet të provojë mundësinë e ardhjes së një dëmi serioz që është vështirë të riparohet në të ardhmen. Ndërkaq, gjykata duhet të gjejë një balancë ndërmjet interesave të paditësit, të paditurit dhe interesit publik, me qëllim ruajtjen e këtijekuilibri deri në përfundim të gjykimit, me të vetmin qëllim që, e drejta epretenduar në padi të jetë plotësisht e garantuar.

Gjykata vlerëson se, kërkesa për marrjen e masave për sigurimin e padisë, si kërkesë e natyrës së ngutshme dhe përkohëshmenjëkohësisht, është ligjërish e pranueshme, nëse plotësohen kumulativisht dykushte thelbësore: **Së pari**, ekzistenca e mundshmëe një të drejte për të cilën kërkohet mbrojtje gjatë procesit të gjykimit të padisë (*fumus boni juris*). **Së dyti**, ekzistenca e frikës që ekzekutimi i vendimit për të drejtën që kërkohet të mbrohet do të bëhet i pamundur ose i vështirë për shkak të vonesës së gjykimit (*periculum in mora*). Ndërsa kushti i parë i jep legjitimitet formal kërkuesit nëngritjen e kësaj kërkesë, kushti i dytë përbën shkakun ligjor, arsyen përsekërkohet marrja e masës së sigurimit në mënyrë të ngutshme.

Sa i përket ekzistencës së mundshme të një të drejte (*fumus boni juris*), Gjykata çmon të rëndësishme të theksojë se, gjatë gjykimit të kërkesës për sigurim padie, paditësi nuk ka detyrimin të provojë ekzistencën konkrete të tëdrejtës, ajo i takon gjykimit mbi themelin e padisë, por vetëm mundësinë e ekzistencës së saj dhe, gjykatës i kërkohet verifikimi i një probabiliteti tëarsyeshëm mbi ekzistencën e saj. Ky vlerësim mund të bëhet vetëm mbi provat eparaqitura nga kërkuesi dhe shqyrtimit sipërfaqësor të tyre (*summaria cognito*), pasi shqyrtimi substancial dhe objektiv mbi të drejtën e pretenduar në padi, i përket gjykimit të themelit. Me anë të këtij vlerësimi gjykata krijon njëbindje *prima facie* për suksesin e mundshëm të padisë, gjithmonë dhe përfaqësa është e nevojshme nëse duhet apo jo të merret masa për sigurimin e saj, pa e paragjykuar themelin e çështjes. Në këtë kuptim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në Vendimin Unifikues Nr.10, datë 23.04.2004, shprehen se: “Gjykatat vendimin për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë nuk duhet ta mbështesin në fakte apo veprime, si dhe nëcilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtu shqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet të trajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel, ose nuk është e paanshme në



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

gjykim.”. Pra, nëseparaqitet një kërkesë e tillë, detyrë e gjykatës është që të vlerësojë nësemasa e përkohshme për sigurimin e padisë e kërkuar nga paditësi është nëpërputhje me kërkesat e nenit 28 e vijues të Ligjit nr.49/2012 dhe nenit 202 evijues të Kodit të Procedurës Civile dhe në veçanti, nëse ka arsye të dyshohetse ekzekutimi i vendimit eventual për të drejtat e paditësit do të bëhet ipamundur, ose i vështirë.[2] Por,vendimi i gjykatës që disponon mbi kërkesën për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, nuk paragjykon në asnjë rast zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket frikës së rrezikut qëekzekutimi i vendimit do të bëhet i pamundur ose i vështirë për shkak të vonesës së gjykimit, Gjykata vlerësonse, kjo frikë ka të bëjë me natyrën e mosmarrëveshjes dhe pasojave që sjellzhvillimi normal i procesit gjyqësor mbi shqyrtimin e themelit të padisë, duke bërë të pamundur ose të vështirë ekzekutimin e të drejtës së njohurpotencialisht me vendim përfundimtar. Vendimi i gjykatës që dispononmbi kërkesën për vendosjen e masës së sigurimit të padisë, nuk paragjykon zgjidhjen në themel të çështjes, por synon thjesht që të sigurojë një situatë konstantefaktike dhe juridike, e cila ndihmon në zhvillimin e gjykimit dhe mundësoneventualisht që të mos dëmtohen interesat e asnjërës nga palët ndërgjyqësederisa të zgjidhet mosmarrëveshja në themel. Në këto kushte, nëpërmjetvendosjes së masës së sigurimit të padisë, gjykata garanton në mënyrë tëtërthortë dhe potenciale, zbatimin e vendimit të saj përfundimtar.

Nën dritën e kushteve thelbësore të lartëcituara dhe, në harmoni të plotëme to, ligjvënësi në nenin 28 e vijues tëLigjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeveadministrative”, parë në harmoni me nenin 202 e vijues të Kodit tëProcedurës Civile, ka sanksionuar në mënyrë të detajuar kushtet konkrete qëduhen analizuar në mënyrë që gjykata të disponoj lidhur me kërkesën për marrjen e masës së përkohëshme për sigurimin e padisë. Sikundër është theksuar mësipër, barra e provës për të provuar që plotësohen këto kushtet i takonkërkuesit/paditësit.

Në nenin 28/1 të Ligjitnr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeveadministrative”, sanksionohet: “*Meparaqitjen e padisë, paditësi mund t’i kërkojë gjykatës marrjen e masave tësigurimit të padisë, në rastet kur ai tregon se gjatë kohës së nevojshme tëprocesit, derisa të arrihet në marrjen e vendimit të themelit, ekzistonmundësia e ardhjes së një dëmi të rëndë e të pariparueshëm, që rrjedh ngaekzekutimi i veprimi administrativ.*”. Sakaq, nenin 29të këtij ligji, parashikohet:

“Gjykatavendos sigurimin e padisë, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
a) ekzistondyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresa, për mundësinë e shkakimit të njëdëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për paditësin; b) nuk cenohetrëndë interesi publik; c) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, paditësi jepgaranci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

mund t'i shkaktohet tëpaditurit nga sigurimi i padisë. Në zbatim të kushteve të evidentuara në këto dispozita, në lidhje me kërkesën për marrjen e masave të sigurimit të padisë, Gjykata vlerëson se, pranimi i kërkesës për sigurimin e padisë kushtëzohet nga plotësimi i kushteve të mëposhtme: i) ekziston dyshimi i arsyeshëm, i bazuar në shkresë, për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për palën kërkuese/paditëse; ii) pranimi i kërkesës për sigurimin e padisë nuk cenon rëndë interesin publik; iii) nëse shihet e nevojshme nga gjykata, kërkuesi/paditësi jep garanci, në llojin dhe masën e caktuar për dëmin, që mund t'i shkaktohet personit të tretë/të paditurit nga sigurimi i padisë; iv) kërkuesi/paditësi duhet të provojë që deri në dhënien e vendimit mbi themelin e padisë, ekziston mundësia që t'i shkaktohet një dëmi rëndë e i pariparueshëm, që rrjedh nga ekzekutimi i veprimit administrativ.

Lidhur me kushtin (i): ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, i bazuar në shkresë, për mundësinë e shkakimit të një dëmi të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për palën kërkuese/paditëse, që derivon nga mospezullimi i veprimit administrativ. Gjykata vlerëson se, kjo është premisa e parë ligjore, në funksion të kërkesës për sigurimin e padisë nëkuadër të nenit 28 e vijues të Ligjit nr.49/2012. Në bazë të kësaj premiseligjore, dëmi nuk mund të jetë i prezumuar, por duhet të provohet konkretisht dhe se, ky dëm duhet të ketë tiparet e dëmit të rëndë, të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për palën kërkuese/paditëse. Gjykata çmon se, këto tipare të dëmit, duhet të vërtetohen në mënyrë kumulative në një rast konkret, pra duhet të bashkëekzistojnë. Mungesa vetëm e njërit prej tyre, passjell refuzimin e kërkesës për sigurimin e padisë. Dëmi i pretenduar nga pala kërkuese/paditëse në funksion të kërkesës për marrjen e masës me karakter të ngutshëm dhe për kohshëm, për sigurimin e padisë, duhet të ketë cilësitë e një dëmi të rëndë, të atëçastshëm dhe të pakthyeshëm.

Në lidhje me tiparin e dëmit, që duhet të jetë irëndë: Ligjvënësinuk ka bërë kategorizime, se kur një dëm është i rëndë dhe jo i rëndë. Kjosigurisht ka logjikë juridike, për faktin se ndikimi ekonomik-social qëpassjell një akt administrativ i caktuar, ndaj një personi fizik a juridik, kushtëzohet nga subjekti ndaj të cilit kundrejtohet akti administrativ. Një dëm i tillë nuk mund të merret si i mirëqenë, por duhet të provohet nga pala kërkuese/paditëse. Provueshmëria e mundësisë potenciale për shkaktimin e dëmit të rëndë në rastin e kërkesës për sigurimin e padisë, obligon palën kërkuese/paditëse, jo vetëm të parashtrojë pretendimet lidhur me natyrën e dëmit dhe pasojave që i shkaktohen, por edhe të argumentojë konkretisht ku konsiston ky dëm, duke paraqitur prova shpresore që krijojnë dyshimin e arsyeshëm për mundësinë që kërkuesi/paditësi t'i shkaktohet një dëm i rëndë në rast se nuk pranohet kërkesa për sigurimin e padisë.

Në rastin konkret, kërkuesi ***** pretendon se, ekziston jo vetëm



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

dyshimi, por është fakt se nëse zbatohet menjëherë urdhëripër transferimin dhe më pas për përjashtimin e tij nga AMP-ja, i shkaktohet njëdëm i rëndë dhe i pakthyeshem që lidhet me ndërprerjen e procesit të vlerësimitkalimtar dhe periodik të tij në kuadër të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësiminkalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës sëRepublikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”.

Në nenin 6 të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik tëpunonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë sëMbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, janë përcaktuar fushat eushtrimit të veprimtarisë së institucionit të vlerësimit kalimtar. Konkretisht,në nenin 6 të LigjitLigjit nr.12/2018 “Përvlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”,parashikohet se: “1.

Agjencia e Mbikëqyrjes Policore vlerëson punonjësitnë pozicionet e mëposhtme: a) drejtor dhe zëvendësdrejtor ipërgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i Drejtorisë Qendrore, drejtor nëstrukturat e veçanta, drejtor e zëvendësdrejtor vendor, drejtor në drejtoritë ekufirit dhe migracionit, shef komisarati, shef sektori nënivele qendror e vendor, që mbulon fushën e krimi të organizuar, krimitekonomik/financiar dhe policisë rrugore në Policinë e Shtetit; b) drejtor dhezëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie dhe shef njësie në Gardën eRepublikës; c) **drejtor dhe zëvendësdrejtor i përgjithshëm, drejtordrejtorie, shef sektori në nivel qendror dhe vendor në Agjencinë e MbikëqyrjesPolicore;** ç) punonjësit që do të emërohen në strukturën e vlerësimitkalimtar/periodik në AMP; d) çdo punonjës që emërohet në pozicionet epërcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “d”, të pikës 1, të këtij neni bëhetsubjekt i vlerësimit. 2. **Subjektet e vlerësimit, të përcaktuara në pikën 1të këtij neni, kanë detyrimin të plotësojnë dhe të dorëzojnë formularët edeklarimit të pasurisë, të miratuara me udhëzim të ministrit të Brendshëm dheinspektorit të përgjithshëm të ILDKPKI-së, si dhe formularët e deklarimit tëkontrollit të figurës dhe profesionalizmit, të miratuara me udhëzim tëministrit të Brendshëm, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e udhëzimit ose ngadata e emërimit në funksionet e sipërpërmendura.”.**

Ndërkohë, në nenin 57 të Ligjit Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve tëPolicisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policorenë Ministrinë e Brendshme”, parashikohet se: “1. *Kur punonjësi jepdorëheqjen ose akti i lirim formalizohet gjatë fazës së hetimit administrativ,trupa e vlerësimit merr vendim për ndërprerjen e procesit të vlerësimit pa njëvendim përfundimtar, sipas Kodit të Procedurës Administrative.”.*

Në vijim të kuadrit ligjor të mësipërm,rezulton që subjekt i vlerësimit kalimtar dhe periodik në kuadër të Ligjitnr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, janë vetëm punonjësit e AMP-së në pozicionet: **drejtordhe zëvendës drejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie, shef sektori në nivel qendror dhe vendor në AMP**. Në këtë kuadër, sipas nenit 57 të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, në rast se gjatë fazës së hetimit administrativ, punonjësi i AMP-së jep dorëheqjen nga pozicionet që janë subjekt i vlerësimit kalimtar dhe periodik, apo formalizohet akti i lirit apo përjashtimit të tij nga këto pozicione që janë subjekt i vlerësimit kalimtar dhe periodik, trupa evlerësimit merr vendim për ndërprerjen e procesit të vlerësimit pa një vendim përfundimtar, sipas Kodit të Procedurës Administrative.

Duke u rikthyer në rastin konkret objektgjykimi rezulton se, kërkuesi ***** në kushtet kur ushtron detyrën në pozicionin: Drejtor në Drejtorinë Rajonale të AMP-së Vlorë & Gjirokastrë është subjekt i vlerësimit kalimtar dhe periodik në kuadër të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, konkretisht nenit 6 pika 1 germa “c” e tij. Për rrjedhojë, zbatimi i menjëhershëm i urdhërit për transferimin dhe më pas për përjashtimin e tij nga AMP-ja, sipas Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 “Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësit të AMP-së” dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 “Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së”, të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, passjell për kërkuesin ***** ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të tij në kuadër të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, pa një vendim përfundimtar.

Në këtë kuadër, Gjykata çmon të theksojë që në rastin konkret ndërprerja e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të kërkuesit ***** në kuadër të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, pa një vendim përfundimtar, nëse zbatohet menjëherë urdhëri për transferimin dhe më pas për përjashtimin e tij nga AMP-ja, sipas Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 “Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së” dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 “Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së”, të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, cenon të drejtën për punë të tij dhe konsiderohet dëm i rëndë në kuptim të nenit 29 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, për shkak se nuk kemi të bëjmë vetëm me curinë profesionale të kërkuesit ***** në AMP, por ndërprerja e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik pa



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

një vendim përfundimtar pengon zhvillimin profesional dhe në karrierë të kërkuesit, e konkretisht duke e penguar për të konkuruar në pozicione të cilat janë subjekt i vlerësimit kalimtar dhe periodik. Për më tepër që kërkuesi ***** është emëruar në pozicionin: Drejtor në Drejtorinë Rajonale të AMP-së Vlorë & Gjirokastrë me procedurën e ngritjes në detyrë. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se dëmi që shkaktohet duhet të kategorizohet si i rëndë.

Ekzistenca e kësaj situate faktike, ku rezulton i provuar fakti që zbatimi i menjëhershëm i urdhërit për transferimin dhe më pas përpërkashtimin e tij nga AMP-ja, sipas Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 "Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së" dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 "Për përkashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së", të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, passjell për kërkuesin ***** ndërprerjen e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të tij në kuadër të Ligjit nr.12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësvetë Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme", pa një vendim përfundimtar, e marrë në analizë mëvete dhe në tërësi me mungesën e procedurës së transferimit dhe përkashtimit të kërkuesit nga AMP-ja, krijon dyshimin e arsyeshëm, të bazuar në shkresë, se kërkuesi mundësi për shkaktimin e dëmit të rëndë për kërkuesin ***** në rast mospezullimi të zbatimit të akteve administrative objekt gjykimi, Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 "Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së" dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 "Për përkashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së", të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, derinë zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Pasoja e rëndë që shkaktojnë akteve administrative objekt gjykimi, Urdhëri Nr.582, datë 05.08.2025 "Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së" dhe Urdhëri Nr.590, datë 06.08.2025 "Për përkashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së", të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, është ndërprerja e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik për kërkuesin pa një vendim përfundimtar dhe pengimi i zhvillimit profesional dhe në karrierë të kërkuesit ***** duke cenuar të drejtën për punë të tij. E drejta punë është një drejtë kushtetuese, e parashikuar si e tillë në nenin 49 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë. Sipas kësaj dispozite kushtetuese parashikohet se: "1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që eka zgjedhur ose pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional. 2. Të punësuarit kanë të drejtë të mbrojtjes shoqërore të punës.". Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se dëmi që shkaktohet duhet të kategorizohet si i rëndë.

Poashtu, Gjykata çmon të theksojë se, marrja e masave për sigurimin e padisë nuk ka për qëllim që të garantojë mundësinë potenciale që pala kërkuese/paditëse të përfitojë gjatë kohëzgjatjes së masës së sigurimit, përkundrazi, sigurimi i padisë synon të parandalojë mundësinë evidente që



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

palës kërkuese/paditëse të mund t'ishkaktohet një dëmi i rëndë, i pakthyeshem dhe atëçastshëm, deri në shqyrtimin e themelit të çështjes. Pezullimi izbatimit të akteve administrative objekt gjykimi, Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 "Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së" dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 "Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së", të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, nëpërmjet vijimit të ushtrimit të detyrës nga kërkuesi ***** në pozicionin: Drejtor në Drejtorinë Rajonale të AMP-së Vlorë & Gjirokastrë, sidhe po ashtu nëpërmjet vijimit të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të tij në kuadër të Ligjit nr.12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme", nuk e tejkalon qëllimin institutit procedural të sigurimit të padisë, duke iu referuar ndër të tjera edhe vendimit nr.10/2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, një masë e tillë siguri i shërben vendimit përfundimtar të Gjykatës në lidhje me të drejtat e palës kërkuese dhe për më tepër garanton pandryshueshmërinë juridike të situatës deri në marrjen e vendimit të themelit. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se dëmi që shkaktohet duhet të kategorizohet si i rëndë dhe që nuk e tejkalon qëllimin institutit procedural të sigurimit të padisë referuar edhe vendimit nr.10/2004 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

Në lidhje me tiparin e dëmit, që duhet të jetë i pakthyeshem: Dëmi është i pakthyeshem në kuptim të ligjit, kur pavarësisht pranimit të padisë lidhur me themelin e çështjes, është e pamundur që pala kërkuese/paditëse të rivendos në vend të drejtën që i është cenuar si rrjedhojë e dëmit të shkaktuar nga mospezullimi i aktit administrativ. Dëmi është i pakthyeshem atëherë kur cenon efektivitetin dhe dobishmërinë e procesit gjyqësor, që do të realizohet mes palëve në të ardhmen. Sakaq, nuk do të konsiderohet i pakthyeshem dëmi, kur, pavarësisht pasojave që sjellë, është i tillë që, e drejta që kërkuesi/paditësi kërkon të realizojë dhe të njohë nëpërmjet procesit gjyqësor, mund të rivendoset në vend në eventualitetin e pranimit të padisë dhe vendimi përfundimtar nuk mbetet i paekzekutueshem.

Në vlerësimin paraprak dhe sipërfaqësor të fakteve të çështjes që kryen Gjykata gjatë shqyrtimit të kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, arrihet në përfundimin se, në rast se nuk do të pezullohen aktet administrative objekt gjykimi, Urdhëri Nr.582, datë 05.08.2025 "Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së" dhe Urdhëri Nr.590, datë 06.08.2025 "Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së", të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, kërkuesi ***** Ahemtaj do të privohet nga mundësia për të përfunduar procesin e vlerësimit kalimtar dhe periodik me një vendim përfundimtar ngatruar e vlerësimit në kuadër të Ligjit nr.12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme", si dhe po ashtu do të privohet nga zhvillimi profesional dhe në karrierë duke cenuar të drejtën për punë të tij. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se përmbushet dhe kriteri ligjor i pakthyeshmërisë së dëmit të pretenduar nga kërkuesi ***** , në kushtet kur ekzistenca e një privimi të tillë shkakton pasoja joproporcionale në ecurinë profesionale dhe në karrierë të kërkuarit, pasi që sikurse u theksua më sipër në këtë vendim nuk kemi të bëjmë vetëm me ecurinë profesionale të kërkuarit ***** në AMP, por ndërprerja e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik pa një vendim përfundimtar pengon zhvillimin profesional dhe në karrierë të kërkuarit, konkretisht duke e penguar për të konkuruar në pozicione të cilat janë subjekt i vlerësimit kalimtar dhe periodik. Për më tepër që kërkuesi ***** është emëruar në pozicionin: Drejtor në Drejtorinë Rajonale të AMP-së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

Vlorë&Gjirokastrë me procedurën e ngritjes nëdetyrë. Në pasojë, Gjykata vlerëson sepërmbushet kriteri ligjor i pakthyeshmërisë së dëmit të pretenduar nga palakërkuese.

Në lidhje me tiparin e dëmit, që duhet të jetë i atëçastshëm:

Gjykatavlerëson se në rastin konkret objekt gjykimi, provohet atëçastshmëria e dëmit dhe situata e emergjencës, pasi që ndërprerja e procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik për kërkuesin, konsiderohet si një dëm i atëçastshëm. Pradëmi i rëndë dhe i pakthyeshëm për kërkuesin ***** , ka filluar që më datë 06.08.2025 dhe nuk mund të presë përfundimin e gjykimit.

Lidhur me kushtin (ii): pranimi i kërkesës për sigurimin e padisë nuk cenon rëndë interesin publik, Gjykata çmon të sqarojë se ka për detyrë mbrojtjen e të drejtave e të interesave si të individit apo të personit të të drejtës private ashtu dhe të publikut. Padrejtësia ndaj një subjekti të vetëm ka të njëjtën vlerë si dëmi që ishkaktohet publikut nga veprimet e paligjshme të administratës, ndaj edhe ligjipërcakton se, nuk duhet të cenohet rëndë interesi i publikut. Në rastin e Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” ndryshe nga sa parashikon legjislacioni procedural civil barrae provës për të provuar ligjshmërinë e aktit apo veprimit administrativ i takon organit administrativ duke zhvendosur barrën e provës. Sipas jurisprudencës së përpunuar prej Gjykatës Kushtetuese në vendimin nr.2 datë 18.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë është elaboruar se: “[...] Koncepti kushtetues i interesit publik, ashtu siç është trajtuar në praktikë të vazhdueshme nga Gjykata, është mjaft i gjerë dhe duhet parë në këndvështrimin e dispozitës konkrete që paraqitet për kontroll parasaj. Është e vështirë të radhiten në mënyrë shteruese çështjet që përbëjnë interes publik ose të arsyesh publike që mund të justifikojnë ndërhyrjen në një të drejtë themelore. Ato mund të renditen vetëm negativisht, pra në aspektin ekufizimit të çdo rasti konkret. Në këtë mënyrë, pajtueshmëria e masës kufizuese të marrë nga ligjvënësi me pranimin ose jo të nevojës së kufizimit duhet të verifikohet në aspektin e kushteve të vendosuranga neni 17/1 i Kushtetutës dhe konkretisht të ekzistencës së interesit publik[...]”.

Po ashtu, Gjykata thekson se, për sa i përket analizës së interesit publik, në praktikën e tij Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka argumentuar se gjykimi administrativ për marrjen e masës së sigurimit të padisë ka një veçanti në raport me atë civil, lidhur me nevojën për të argumentuar natyrën e (mos)cenimit të rëndë të interesit publik, në aspektin e një balance që duhet të vendoset mes mirëqenies individuale dhe asaj komunitare, e cila përshkon gjykimin administrativ në tërësinë e tij (**shih vendimi nr.818, datë 21.12.2020 dhe vendimi nr.953, datë 14.12.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**).

Interesi publik ka vend në ato raste kur mpleksen kategori të gjerashoqërore dhe, kur këto kategori impaktohen si rrjedhojë e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

vendimmarjes sëgjykatës. Në rastin objekt gjykimi, nuk rezulton që vendimmarrja e gjykatës tëafektojë interesa të gjerë shoqërorë, me pasojë cenimin e tyre. Aktetadministrative objekt gjykimi, Urdhëri Nr.582, datë 05.08.2025 “Për transferim dhe emërim nëdetyrë të një punonjësi të AMP-së” dhe Urdhëri Nr.590, datë 06.08.2025 “Përpërgjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së”, të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, që kërkuesi kërkon tëpezullojë zbatimin e tyre, janë akte administrative individuale, që sjellin të drejta dhe detyrime vetëm për kërkuesin ***** dhe parimisht nuk i shërbejnë interesit komunitar. Për rrjedhojë, marrja e masës së sigurimit të padisë nërastin objekt gjykimi nuk vlerësohet nga Gjykata që cenon interesin publik, ndaj derisa të arrihet në një vlerësim me vendimpërfundimtar, për aq kohë sa zgjat procedura gjyqësore, e drejta e pretenduarnga pala kërkuese, *****, duhet të sigurohet, me qëllim që ankimgjyqësor të jetë efektiv.

Përpos sa më sipër u arsyetua, Gjykata çmon të theksojë se, masa esigurimit të padisë përbën kufizim të të drejtave të palës së paditur/personit të tretë dhe, si e tillë, në kuptim të nenit 17 të Kushtetutës së Republikës sëShqipërisë, duhet të jetë proporcionale dhe e justifikuar ligjërisht, përmbrojtjen e të drejtave të palës tjetër ose nga një interes publik. Gjykatavlerëson se neni 29 germa “b” drejtëpërdrejtë ka pranuar se në fushën egjykimit administrativ, në rastet e pranimi të kërkesës për sigurimin epadisë, interesi publik në një masë sado minimale, cenohet. Kjo për shkak sepezullimi i zbatimit të një akti administrativ ose mjete të tjera tëpërshtatshme për sigurimin e padisë (kur pezullimi i ekzekutimit nuk ofronmbrojtje të mjaftueshme) cenon veprimtarinë e organit administrative nëvetvete, veprimtari kjo e cila në mbështetje të nenit 4, 11, 13, 15,konsiderohet e ligjshme dhe e ushtruar në mënyrë të përgjegjshme. Ligji nr.49/2012 ka vendosur si kusht për caktimin e masës së sigurimit të padisëmoscenimin e rëndë të interes publik (**përmë tepër shih vendimin 00 -2021-1318, datë 29.07.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë**).

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin unifikues nr.10, datë 24.03.2004 kanë mbajtur qëndrimin se: “[...]Gjykatatvendimin për marrjen e masës së përkohëshme për sigurimin e padisë nuk duhet tëmbështesin në fakte apo veprime, si dhe në cilësimin juridik të tyre, që kanë të bëjnë me shqyrtimin dhe zgjidhjen e çështjes në themel. Gjithashtushqyrtimi i kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë duhet tëtrajtohet në një mënyrë të tillë që të shmangë çdo lloj perceptimi, sipas të cilit gjykata e ka paragjykuar zgjidhjen e çështjes në themel apo nuk është e pa anëshme në gjykim. [...]”. Në rastin objekt gjykimi, pezullimii zbatimit të akteve administrativeobjekt gjykimi, Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 “Për transferim dhe emërim në detyrë tënjë punonjësi të AMP-së” dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 “Për përjashtimnga detyra të një



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

punonjësi të AMP-së”, të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, nëpërmjet vijimit të ushtrimit të detyrës nga kërkuesi ***** në pozicionin: Drejtor në Drejtorinë Rajonale të AMP-së Vlorë & Gjirokastrë, sidhe po ashtu nëpërmjet vijimit të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të tij në kuadër të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, nuk konstatohet qëndrim në kundërshtim me konkluzionet e arritura në këtë vendim unifikues, si dhe po ashtu nuk vlerësohet nga Gjykata që cenon interesin publik, ndaj derisa të arrihet në një vlerësim me vendim përfundimtar, për atë kohë sa zgjat procedura gjyqësore, e drejta e pretenduar nga pala kërkuese, ***** duhet të sigurohet, me qëllim që ankimi gjyqësor të jetë efektiv.

Lidhur me kushtin (iii): përsa i përket garancisë nga pala kërkuese/paditëse lidhur me dëmin që mund t'i vijë personit të tretë/palës së paditur ngasigurimi i padisë, Gjykata vlerëson se ky kriter është lënë nga ligjvënësinë vlerësim të gjykatës rast pas rasti. Megjithatë, vlerësimi i nevojës së garancisë, nuk duhet kuptuar si e drejtë e pakushtëzuar për gjykatën dhe atë që më pak, si e drejtë, bazueshmëria në ligj e së cilës të mund të konsiderohet e pakontrollueshme dhe e pa verifikueshme në shkallë pasardhëse të gjykimit. Përderisa ligjvënësi ka parashikuar edhe mundësinë e vendosjes së garancisë, është detyrë e gjykatës që në çdo rast që gjykon një kërkesë për marrjen e masës së sigurimit, të mbajë parasysh faktin nëse është apo jo e nevojshme vendosja e garancisë nga ana e palës kërkuese/paditëse dhe, kur ekzistojnë shkaqe dhe rrethana që e bëjnë të nevojshme, obligohet të urdhërojë vendosjen e garancisë. Duke iu rikthyer çështjes objekt gjykimi, Gjykata vlerëson se, nuk ka vend dhe nuk është e nevojshme që nga ana e kërkuesit ***** të vendoset garanci pasiqë nga pezullimi i zbatimit të akteve administrative objekt gjykimi, Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 “Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së” dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 “Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së”, të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, nuk i shkaktohet asnjë dëm personit të tretë, AMP-së.

Në vijim të sa më sipër u arsyetua, Gjykata vlerëson se, marrja e masës së sigurimit të padisë, për pezullimin e zbatimit të akteve administrative objekt gjykimi, Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 “Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së” dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 “Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së”, të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, nëpërmjet vijimit të ushtrimit të detyrës nga kërkuesi ***** në pozicionin: Drejtor në Drejtorinë Rajonale të AMP-së Vlorë & Gjirokastrë, si dhe po ashtu nëpërmjet vijimit të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të tij në kuadër të Ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, është e përshtatshme dhe e dobishme për të mbrojtur të drejtat e ligjshme të kërkuarit *****. Kjo masë është nënrespektim të nenit 28, 29 dhe 30 të ligjit organik nr.49/2012, si dhe vendimitunifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr.10, datë 24.03.2004, ku shprehimisht parashikohet se: “[...] Gjykata rast pas rasti ka diskrecion të vendosë një masë të natyrës së sigurimit të padisë që ajo e gjykon të dobishme dhe të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat e paditësit, por parrezikuar në të njëjtën kohë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshmetë të paditurit [...]”.

Për këto arsye, Gjykata çmon se kërkesa për sigurim të padisë është e bazuar në prova dhe në ligj, e si e tillë duhet pranuar, pasindodhemi në kushtet e neneve 28, 29 dhe 30 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” që ligjërojnë marrjen e masës së sigurimit të padisë për pezullimin e zbatimit të akteve administrative objekt gjykimi, Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 “Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së” dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 “Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së”, të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, nëpërmjet vijimit të ushtrimit të detyrës nga kërkuari ***** në pozicionin: Drejtor në Drejtorinë Rajonale të AMP-së Vlorë & Gjirokastrë, si dhe po ashtu nëpërmjet vijimit të procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të tij në kuadër të Ligjit nr.12/2018 “Përvlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”.

Sakaq, në zbatim të nenit 28 pika 2 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, sipas të cilit parashikohet se: “Kërkesa për sigurim të padisë, për shkak të rrethanave të çështjes, mund të paraqitet edhe parangritjes së padisë. Në këto raste, gjykata, kur lejon sigurim të padisë, cakton edhe një afat, jo më të gjatë se 10 ditë, brenda të cilit duhet të ngrihet padia”, Gjykata i cakton palës kërkuar, ***** një afat 10 (dhjetë) ditor, për depozitim të padisë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Në lidhje me ekzekutimin e këtij vendimi gjyqësor: AMP e ekzekuton në mënyrë të menjëhershme dhe vullnetare këtë vendim gjyqësor, që shprehet për pezullimin e zbatimit të akteve administrative objekt gjykimi, Urdhërit Nr.582, datë 05.08.2025 “Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësi të AMP-së” dhe Urdhërit Nr.590, datë 06.08.2025 “Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së”, të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, nëpërmjet vijimit të ushtrimit të detyrës nga kërkuari ***** në pozicionin: Drejtor në Drejtorinë Rajonale të AMP-së Vlorë & Gjirokastrë, si dhe po ashtu nëpërmjet vijimit të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

procesit të vlerësimit kalimtar dhe periodik të tij në kuadër të Ligjit nr.12/2018 “Përvlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”. Në kuptimtë nenit 65 të Ligjit nr.49/2012 “Përgjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, vendimi për pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë është i ekzekutueshëm në mënyrë të menjëhershme. Në rast mos ekzekutimi vullnetar të këtij vendimigjyqësor, ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror ose privat për ekzekutimin e detyrueshëm të tij.

Në lidhje me shpenzimet gjyqësore: Bazuar në nenin 102 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, shpenzimet gjyqësore në vlerë totale prej 400 (katërqind) Lekë, të përbëra nga 200 (dyqind) Lekë taksëkërkese dhe 200 (dyqind) Lekë shpenzime për njoftime, lihen siç janë bërë.

Në lidhje me të drejtën e ankimit: Në referim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, kundër vendimit të gjykatës për pranimin apo refuzimin e kërkesës për sigurimin e padisë, për heqjen, ndryshimin ose zëvendësimin e vendimit për sigurimin e padisë, mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën më të lartë. Kësisoj, palët ndërgjyqëse kanë të drejtën e kundërshtimit të këtij vendimi në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, brenda afatit ligjor 5ditor, duke filluar ky afat, nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsytuar palëve ndërgjyqëse.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 28, 29, 30, 32 dhe 65 të Ligjit nr.49/2012 “Përgjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhenë Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

[1] Janë pjesërisht të cituara sipas përmbajtjes së tyre.

[2] Vendimi Nr.479, datë 27.10.2011 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

Vëren:

Për keto arsye:

.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

Vendosi:

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 28, 29, 30, 32 dhe 65 të Ligjit nr.49/2012 “Përgjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhenë Ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së palëskërkuese, ***** , për marrjen e masës së sigurimit të padisë.
2. Pezullimin e zbatimit të aktitadministrativ, UrdhërNr.582, datë 05.08.2025 “Për transferim dhe emërim në detyrë të një punonjësitë AMP-së”, të Agjencisë së Mbikëqyrjes ***** ,deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
3. Pezullimin e zbatimit të aktitadministrativ, UrdhërNr.590, datë 06.08.2025 “Për përjashtim nga detyra të një punonjësi të AMP-së”, të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
4. Në zbatim të nenit 28 pika 2 të Ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, Gjykata i cakton palës kërkuese, ***** , një afat 10 (dhjetë) ditor, për depozitimin e padisë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
5. Ky vendim është i ekzekutueshëm menjëherë nga Agjenciae Mbikëqyrjes Policore.
6. Në rast mosekzekutimi vullnetar të këtij vendimi gjyqësor, ngarkohet shërbimi përmbarimor gjyqësor shtetëror ose privat për ekzekutimin e detyrueshëm të tij.
7. Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë bërë.
8. Kundër këtij vendimi, lejohet drejta e ankimit të veçantë brenda afatit ligjor 5 (pesë) ditor, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke filluar ky afat nga e nesërmeja enjoftimit të vendimit të arsyetuar palëve ndërgjyqëse.

U shpall në Tiranë, sot më datë 14.08.2025.

**SEKRETARE GJYQËSORE
GJYQTAR**

**XHOVIDJANASUTA
BOSHKU**

MARKO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata Administrative e Shkalles se pare

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.